

Shqiperia zhvillon stervitjen e pare ne Austri

nga Administrator
E hënë, 23 Maj 2016 20:44



Sot mbasdite ekipi yne kombetar ka zhvilluar stervitjen e pare ne Austri. Lojtaret e thirrur nga tranjeri De Biasi kane zhvilluar vaprime te lehta ne fushe dhe ushtrime fizike per tu pershtatur me fushen stervitore.

Në këtë stërvitje kanë marrë pjesë 19 nd 27 futbollistët e thirrur nga De Biasi. Te pranishem ne stervitjen e pare kane qene Berisha, Shehi, Hoxha, Gjimshiti, Ajeti, Cana, Lenjani, Abrashi, Rrahmani, Rashica, Shala, Lila, Basha, Gashi, Mavraj, Roshi, Bala, Cikalleshi dhe Hysaj. Lojtaret e tjere te kombetares do te afrohen ne ditet ne vijim pasi te kene perfunduar impenjimet me skuadrat e tyre.

Sipas programit, stërvitja e radhës do të zhvillohet ditën e hënë në orën 10.00, ndërsa ajo e pasdites në orën 17.30. I njëjti regjim stërvitor do të vazhdojë deri më datë 27 maj. Me date 29 maj ne oren 17:30 Shqiperia do te zhvilloje ndeshjen e pare miqesore kunder Katarit.